

VENDIM
Nr. 1034, datë 16.12.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR RIFORCIMIN E
PALLATIT TË KULTURËS “DEDE NDUE LAZRI”, BASHKIA LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për riforcimin e pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri”, Bashkia Lezhë.
 2. Përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësia zbatuese Bashkia Lezhë, në masën 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë, për financimin e riforcimit të pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri”, Bashkia Lezhë.
 3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e riforcimit të pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri”, Bashkia Lezhë, të jetë në masën 26 000 000 (njëzet e gjashtë milionë) lekë dhe të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.
 4. Fondi për financimin e riforcimit të pallatit të kulturës “Dedë Ndue Lazri” i transferohet njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.
 5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe